

## **RELACION TEKNIK**

*Objekti:* *Riparim dhe perforcim i strukture se kosit perdhe.*

*Zhvillues:* *Gjykata e Apelit Durrës*

*Adresa:* *Bashkia Durrës*

Objekti ekzistues eshte 3 dhe 4 kate mbi toke. Nuk ka kat nentoke.

Ne projektin teknik, pjesa e ketij aplikimi tregohet qarte per llojin e punimeve qe do te kryhen per riparimin e mureve dhe rifiniturave si dhe perforcimin e nje kolone ne katin perdhe.

Ne kete objekt do te kryhen punime riparimi por pa ndryshuar strukturen ekzistuese, vetem duke e perfocuar ate.

Per shkak te termeti te rene ne dt. 26/11/2019 ky objekt ka pesuar disa demtime te strukturae dhe te murature jombajtese (ne katin perdhe). Demtime te lehta (plasaritje < 2mm) jane ne pjesen e mesit te kolones te kosit perdhe, ndersa ne asnje prej kolonave te tjera nuk verehen plasaritje.

Pas kryerjes se llogaritjeve analitike per te sigruuar qendrueshmerine e godines eshte e nevojshme te prforcohet nje kolone e kosit perdhe, duke realizuar mbeshtjelljen e kolones ekzistuese.

Mbeshtjellja do te behet me beton dhe armature hekuri (sipas specifikimeve te projektit konstruktiv).

Struktura e shkalles nuk paraqet asnje problem ne lidhe ne strukturen e saj, verehen vetem disa te shtreses mbrojtese e cila duket e amortizuar per shkak se nuk eshte suvatuar dhe lageshtia ka filluar te oksidoje hekurin. Per ti riparuar dhe mbrojtur armaturen e hekurit duhet te behet pastruni dhe suvatimi me llace me baze cemento.


**Pas perfocimit qe do ti behet struktura, objekti eshte i qendrueshem duke permbushur normat e projektimit dhe te zbatimit sipas Ligjeve ne fuqi.**


Me poshte tregohen disa foto te gjendjes aktuale pas termetit te 26.11.2019:























Punimet qe do te kryhen konsistojne ne:

- marrjen e masave paraprake dhe vendosjen e skelave metalike ne gjithe siperfaqen e katit perdhe dhe katin e pare perpara nderhyrjes per perfocimin e strukures vertikale (kolones) te katit perdhe.
- te behet prishja e mureve jombajtes dhe rifiniturave te dala nga funksioni
- te prishet me kujdes betoni i cepave te kolonave ku verehet oksidimi i armatures
- te pastrohet armatura e oksiduar me furce teli dhe te lyhen me boje anti oksidante
- te vendoset armatura perfocuese e kolones sipas projektit dhe para betonimit kolona ekzistuese te lyhet me solucion per lidhjen sa me te mire te betonit te ri me betonin e vjeter
- duhet te tregohet kujdes ne menyren e vendosjes se stafave dhe armatures vertikale
- te behet vibrimi me kujdes i betonit gjate betonimit
- do te aplikohet mbeshtjella e kolonave ekzistuese me kolona K1 (60x60)
- te ribehen ne pozicionin e meparshem muret e rinj dhe te suvatohen.
- te behet lyerja e te gjithe ambjenteve te brendshme te godines (kt 0,1,2,3)

Ing. Kons. ALMIR MANE

Liç. K 1363/3

Ing. Kons. BESMIR BARE

Liç. K 1373/3